

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë për gjuhën angleze pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në Qendrën e Gjuhëve të Huaja.

A. Kandidatët për personel akademik në Qendrën e Gjuhëve të Huaja, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet universitare në Degën Gjuhë-Angleze sipas sistemit 4 vjeçar ose sistemit 3+2 (Bachelor dhe Master i Shkencave në Gjuhën Angleze), pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës ose në ndonjë universitet të huaj në degë analoge të ekuivalentuara nga MAS;
2. Të kenë notë mesatare mbi 8 (tetë) për studentët që kanë përfunduar studimet në Shqipëri ose të ekuivalentuar mbi 8 (tetë) për studentët që kanë përfunduar studimet jashtë Shqipërisë;
3. Të kenë notë mesatare mbi 8.5 në lëndët e specialitetit ose të ekuivalentuar mbi 8.5 për studentët që kanë përfunduar studimet jashtë Shqipërisë;
4. Të kenë përvojë pune e praktika mësimdhënie në këtë gjuhë si dhe njohuri e shprehi të mira përkthimi, interpretimi e studimi përmes teknologjisë në fushat teknike e inxhinierike;
5. Të njohin si dhe zotërojnë me dëshmi gjuhë perëndimore, së bashku me njohuritë dhe shprehitë e provuara komunikuese e funksionale në këto gjuhë;
6. Kanë përparësi kandidatët që zotërojnë gradën shkencore “Doktor” e tituj më të lartë, si dhe në proces vlerësimi akademik të mëtejshëm.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **07.10.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.